

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime****PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:** Hartimi i Planit të Mbarështimit të Pyjeve e Kullotave (PMPK), Bashkia Kolonjë (EKONOMIA PYJORE Qëndër Novosele), viti 2023.

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

22114311-5 - Projekte, 77231000-8 - Shërbimet për menaxhimin e pyjeve,

**VLERA E FONDIT LIMIT:** 6,158,250 (Gjashtëmilionenjëqindpesëdhjetëetëtmijëedyqinde pesëdhjetë) lekë pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Kolonjë**ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;*

b. *Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 9.*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të Nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik:

**Neni 82, i LPP** “1. *Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojne si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik*”.

**Neni 83 i LPP** “*Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël*”.

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

Sipas percaktimeve të bëra në Shtojcën 8 të DST-ve (**Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit**).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

(shënim: *plotësoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nëligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale në fjalë*).

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatori/et ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2019-2020-2021**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e madhe se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet**.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

#### **Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në **nenin 77 pika 3 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”**, kuparashikohet se: *“Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën”, “Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës”.*

si dhe bazuar në nenin 43, pika 2/c, nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet se:

*“Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:*

c) 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nënkufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Duke marrë në konsideratë vlerën e fondit limit të kësaj procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e madhe se 40% e vlerës së fondit limit** dhe vendosja e këtij limiti nuk kufizon pjesëmarrjen e operatoreve ekonomike.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Autoriteti Kontraktor në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda **datës 31 mars të vitit pasardhës**, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.” pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë) kanë detyrimin të dorëzojnë në administratën tatimore brenda **datës 31 mars të vitit pasardhës** bilancin kontabël së bashku me anekset e tij, si dhe Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji.

---

**2.2.2** Operatori/et ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2019-2020-2021**, të çertifikuara nga autoritetet përkatëse (Dega e Tatim Taksave) ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

---

**2.2.3** Operatori/et ekonomikë ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitetin **për vitin 2022** (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore **dhe për vitin e fundit 2023 (këstet e maturuara)**.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimevetë nenin 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 43, nenit 41, pika 5/ c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr.131/2015 “Për QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Për QKR” i ndryshuar.

Meqenese operatorët ekonomik kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

---

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1.** Operatori/et ekonomikë duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, **në një vlerë jo më të madhe se 20 %** të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar gjatë tri viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.**

**Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:**

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

*(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes të përcaktuara në akt marrëveshje).*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë **në një vlerë jo më të madhe se 20 %** të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

**Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:**

Kontrata e ngjashme është e domosdoshme për të vërtetuar eksperiencën e operatoreve ekonomik ofertues, me qëllim që të garantohet zbatimi i kontratës me sukses, pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së Autoritetit Kontraktor.

---

### 2.3.2 Staf i kryesor e mbeshtetes, punonjesit, çertifikimet

- a. Operatori/et ekonomikë duhet të paraqesë licencë të vlefshme të lëshuar nga QKL me Kod III.7.A Studim,projektim dhe zbatim në fushën e pyjeve dhe kullotave,Shërbime të ekspertizës dhe/ose profesionale lidhur me pyjet dhe / ose kullotat .

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, nenin 41,pika 4,gërma a, si dhe ligjit nr.10 081, datë. 23.02.2009,“**Për licensat,autorizimet dhe lejet e Shqipërisë**”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente,për të siguruar asistencë të kualifikuar për hartimin e planit të mbarështimit.

- 
- b. Operatori/et ekonomikë pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor,drejtues tekniksi** mëposhtë:

- |   |                |
|---|----------------|
| a) Inxhinier Pyjesh                               | <b>1 (një)</b> |
| b) Inxhinier Topograf ose Gjeodet ose Markshajder | <b>1 (një)</b> |

**Për secilin duhet të paraqiten:**

- Kontratë punë e noterizuar
- Diplomë ose çertifikatë
- CV-të e tyre
- Të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë **minimalisht për muajin e fundit.**
- Operatori/et ekonomike ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga administratori i shoqërisë) kryetarin e grupit të shërbimit në objekt i cili duhet të jetë **(Inxhinier Pyjesh).**Gjithashtu së bashku me deklaratën e operatorit ekonomik kërkohet edhe dhënia e deklaratës personale nga vetë kryetari grupit i operatorit ekonomik ku i bashkëngjitet deklaratës së subjektit ofertues.

**Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e deklaratës.Në rast deklarimi të rremë do të veprohet në përputhje me nenin 78, pika 1, gërma ”a” të Ligjit Nr.162/2020 datë.23.12.2021 “Për Prokurimin Publik”.(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anetar i bashkimit, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes të përcaktuara në akt marrëveshje).**

**Inxhinieri iPyjeve duhet të jetë i pajisur me:**

- Certifikatë Personale,për shërbime profesionale për studime e aplikime profesionale,sipas gërmës,(b), pika 1 e nenit 3 të Rregullores nr.3 datë 08.07.2009, "Per çertifikimin e shërbimeve të ekspertizës dhe profesionale në pyje dhe kullota". Gjithashtu të jetë i pajisur me çertifikate kualifikimi mbi “Metodat e Reja të hartimit të planeve të mbarështimit të pyjeve”.
- Certifikatë Personale, për shërbime profesionale për projektme sipas gërmës,(c), pika 1 e nenit 3 të Rregullores nr.3 datë 08.07.2009, "Per çertifikimin e shërbimeve të ekspertizës dhe profesionale në pyje dhe kullota". Gjithashtu të jetë i pajisur me çertifikate kualifikimi mbi “Metodat e Reja të hartimit të planeve të mbarështimit të pyjeve”.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

- c. Operatori/et ekonomikë pjesëmarrës,për realizimin e shërbimeve objekt kontrate duhet të disponojë edhe **stafin mbështetëstë** specializuar/të kualifikuar,(jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- a) Specialist Pyjesh ose Teknik Pyjesh **1 (një)**  
b) Petolog ose Agronom i Përgjithshëm ose Biolog **1 (një)**

**Për secilin duhet të paraqiten:**

- Kontratë punë
- Diplomë ose çertifikatë
- CV-të e tyre
- Të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë **minimalisht për muajin e fundit.**

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i **ndryshuar** , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme pika **2.3.3** gërma (b) dhe (c) janë përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,nenit 11 dhe 18 të ligjit nr.57/2020, datë.30.04.2020,“Për Pyjet”,si dhe nenit 3,pika 1 gërma (b) dhe (c) të Rregullores nr.3 datë 08.07.2009, "Per çertifikimin e shërbimeve të ekspertizës dhe profesionale në pyje dhe kullota",me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

**Kërkesa sa më sipër për Inxhinier Pyjesh** është i nevojshem për ndjekjen e realizimit të shërbimit, përcaktimin e kufijve të ekonomisë pyjore Qëndër Novosele, ndarjen e ngastrave dhe n/ngastrave të ekonomisë pyjore sipas kufijve natyrore ,përcaktimin e lartësisë se ngastrave ,n/ngastrave, matjen e sipërfaqes së tyre, përcaktimin e sipërfaqeve provë që do nevojiten për treguesit dendrometrik, përcaktimin e bimësisë pyjore, kateve , bimësisë barishtore,faunës, etj, hedhja në sistem të të dhënave të terrenit , përpilim i hartave pyjore, llogaritja e volumeve,rritja vjetore,përcaktimi i stadi të zhvillimit të pyllit, mundësia shfrytëzuese.

**Kërkesa sa më sipër për Specialist Pyjesh ose Teknik Pyjesh** është i nevojshem për realizimin e shërbimit duke ndihmuar inxh. e pyjeve në punën në terren që nga ndarja e ngastrave deri në matjet e treguesve dendrometrik.

**Kërkesa sa më sipër për Petolog ose Agronom i Përgjithshëm ose Biolog** është i nevojshem për realizimin e shërbimit në përcaktimin e tipeve të tokës të ekonomisë pyjore , kushtet stacionere të ekonomisë pyjore, përcaktimi faunës së eger etj .

- d. Operatori/et ekonomikë pjesëmarrës në përllogaritjen e ofertës duhet ti referohet Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.**361** datë **12.05.2010** ”Për miratimin e tarifave të shërbimeve profesionale që kryhen në fondin pyjor e kullor publik”.Mospërgatitja e ofertës sipas bazës ligjore të sipërpërmendur përbën shkak për skualifikim.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,si dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.**361** datë **12.05.2010** ”Për miratimin e tarifave të shërbimeve profesionale që kryhen në fondin pyjor e kullor publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të respektojnë parashikimet përkatëse për llogaritjen e ofertës.

**2.3.3.** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojëfuqi punëtoze prej **minimalisht 5 për muajin e fundit**, të vërtetuar me:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqerore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, **për muajin e fundit**.
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi **për muajin e fundit**.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

*(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anetar i bashkimit, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes të përcaktuara në akt marrëveshje).* Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,si dhe të ligjit nr.57/2020, datë.30.04.2020,“Për Pyjet”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtoze të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit,që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përlloritur si më poshtë:

Proceset, veprimtaritë dhe shërbimet që janë të nevojshme për realizimin e hartimit të planit të mbarështimit :

- përcaktimi kufijve të ekonomise pyjore Qëndër Novosele, ndarjen e ngastrave dhe n/ngastrave të ekonomisë pyjore sipas kufijve natyrore,
- përcaktimi lartesisë së ngastrave ,n/ngastrave, matjen e sipërfaqes së tyre
- përcaktimin e sipërfaqeve provë që do nevojiten për treguesit dendrometrik
- përcaktimin e bimësisë pyjore, kateve , bimësisë barishtore,faunës, etj, hedhja në sistem të të dhënave të terrenit , përpilimi hartave pyjore, llogaritja e volumeve , rritja vjetore.

**2.3.4.** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme në **Pronësi** ose **me Qira**:

<b>Gps për matje topografike</b>	<b>copë</b>	<b>1</b>
<b>Hipsometer sunnto</b>	<b>copë</b>	<b>1</b>
<b>Diametermates</b>	<b>copë</b>	<b>1</b>
<b>Metershirit</b>	<b>copë</b>	<b>1</b>
<b>Tryel pressler</b>	<b>copë</b>	<b>1</b>

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicionmjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

**Gps për matje topografike** - Pajisje që përdoret për piketimin e sipërfaqeve provë ,matjen e sipërfaqeve të ngastrave dhe n/ngastrave, kuotimin e parcelave dhe n/parcelave , **Hipsometer sunnto**- Pajisje që përdoret për matjen e lartësisë së drureve pyjor , **Diametermates**-Pajisje që përdoret për matjen e diametrit të drurëve pyjor, **Metershirit** - Pajisje që përdoret për matjen e sipërfaqeve prove dhe ngastrave dhe n/ngastrave, **Tryel pressler**- Pajisje që përdoret për përcaktimin e moshës së drurëve pyjore.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike,Termave të referencës**

Specifikimet Teknike,**Termave të referencës** për procedurën respektive janë hartuar nga komisioni i Përgatitjes së specifikimeve teknike dhe përlllogaritjes së fondit limit i ngritur me urdhër nr.**33** me nr.**380** prot, datë.**24.01.2023**, pjesë përbërëse e strukturës së **Bashkisë Kolonjë**, në përputhje me nenin 36, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 76 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

**Specifikimet Teknike** janë pjesë e setit të dokumentave të ngarkuara në SPE për procedurën respektive.

**Fondi Limit i përlllogaritur** për këtë procedurë është hartuar në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.**361** datë **12.05.2010** ”Për miratimin e tarifave të shërbimeve profesionale që kryhen në fondin pyjor e kullësor publik”, nga komisioni i Përgatitjes së specifikimeve teknike dhe përlllogaritjes së fondit limit i ngritur me urdhër nr.**33** me nr.**380** prot, datë.**24.01.2023**, pjesë përbërëse e strukturës së Bashkisë Kolonjë.

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdokërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes:Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave përcaktoi datën **13.03.2023, ora 11:00**.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt: “**Hartimi i Planit të Mbarështimit të Pyjeve e Kullotave (PMPK), Bashkia Kolonjë (EKONOMIA PYJORE Qëndër Novosele),viti 2023**”, Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurimin anëtar në NJP.

### **Bashkëlidhur këtij proces-verbali:**

- Dokumentat e tenderit
- Preventivi
- Specifikimet teknike dhe termat e referencës

**Njësia e Prokurimit**